



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
OSNOVNI SUD DJAKOVICA – BASIC COURT OF GJAKOVË

---

**AD/GJTHGJA. nr. 03/2023**

Gjykata Themelore Gjakovë – Kryetari i Gjykatës Nikollë Komani, në çështjen e hetimit disiplinor ndaj nënkryetarit të gjykatës D.H., duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga Gj.H. nga Gjakova, pas shikimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të ankesës, me datën 20 nëntor 2023 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Refuzohet ankesa disiplinore e parashtruar nga Gj.H. nga Gjakova, ndaj nënkryetarit të gjykatës D.H., si e pabazuar.

**A r s y e t i m**

Parashtruesja e ankesës, Gj.H. nga Gjakova, me datën 08 nëntor 2023, në Gjykatë e ka dorëzuar parashtruesën me emërtimin “*ankim i veçantë*” ndaj nënkryetarit D.H., e që ka të bëjë me aktvendimin AGJ.nr.232/23, të cilin aktvendim e ka marrur në cilësinë e nënkryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

Pas pranimit të kësaj ankese dhe pas analizimit të përmbajtjes së saj, e njëjta është regjistruar në librin e ankesave disiplinore me numër AD/GJTHGJA.nr.03/2023 me datë 08 nëntor 2023 dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që janë në kompetencë të kryetarit të Gjykatës, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë.

Me shkresën AD/GJTHGJA.nr.03/2023 të datës 09 nëntor 2023, përmes email-it zyrtar është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se janë ndërmarrë veprimet lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e ankueses.

Ankuesja Gj.H., ka paraqitur ankesë ndaj nënkryetarit të Gjykatës D.H., lidhur me aktvendimin AGJ.nr.232/23, me të cilin është refuzuar kërkesa e ankueses në cilësi të paditëses, për përjashtimin e gjyqtarit D.B., nga lënda C.nr.1382/23. Ankuesja ka theksuar se “*lidhur me kërkesën tonë për përjashtim të gjyqtarit D.B. nga çështja juridiko civile kontestimore me numër të lëndës C. nr. 1382/23, gjyqtari i cili ka vendosur në këtë kërkesë tonën për përjashtim, Zv. Kryetari D.H. ka bërë vetëgjyqësi dhe ka shkelur të drejtën time për tu shqyrtuar ajo nga personi i autorizuar për këtë punë, ekskluzivisht si shprehet edhe taksativisht me ligj*”. Ndër të tjera ka theksuar se “*kjo nuk paraqet vetëm shkelje për të nisur hetim për shkelje disiplinore por është shkelje edhe më e gjerë, më e thellë dhe paraqet për Gjykatën argument të fortë për fillim të hetimeve për shkeljen e supozuar që është vepër penale sipas KPPRK-së, sanksionohet me ligj si konflikt i hapur i*

*interesit sepse jemi të sigurt që ai nuk ka pasur të drejtë të vendos për gjyqtarin i cili punon si gjyqtar në po të njëjtën gjykatë dhe i ka munguar kompetenca lëndore dhe mund të them edhe ajo territoriale.*

*Kërkoj që ndaj Zv. Kryetarit, gjyqtarit D.H. të merren masa proporcionalisht sipas peshës së dëmit që na është shkaktuar. Është shkelur në mënyrë të vrazhdë dhe flagrante neni 70, 70.1 mbi kërkesën e palës për përjashtimin e gjyqtarit vendos kryetari i Gjykatës. Kërkoj të revokohet ky aktvendim”.*

Gjyqtari D.H., në deklaratën e tij të dhënë me shkrim ka theksuar se: *“Ankesën e parashtruar nga ankuesja Gj.H. nga Gjakova, e konsideroj si të pa bazuar për faktin se unë kam vendosur lidhur me kërkesën për përjashtimin e gjykatësit D.B. në një çështje kontestimore dhe jam kompetent për të vendosur, pasi që nga KGJK-ja me vendim jam caktuar në pozitën e zëvendës kryetarit të Gjykatës dhe në rastet kur kryetari i Gjykatës nuk gjendet në selinë e Gjykatës për shkak të angazhimeve tjera jashtë gjykatës, unë si zëvendës kryetar i Gjykatës i kam të gjitha kompetencat dhe autorizimet që ta zëvendësoj dhe të shqyrtoj kërkesat e palëve, si dhe jam kompetent për të vepruar lidhur me këto raste pasi që jam kompetent për të zëvendësuar kryetarin e Gjykatës”.*

Kryetari i gjykatës, lidhur me këtë çështje – ankesë ka siguruar shkresat e lëndës dhe atë kërkesën për përjashtim të gjyqtarit D.B. të datës 02.10.2023, deklaratën e gjyqtarit lidhur me kërkesën për përjashtim të datës 03.10.2023, si dhe aktvendimin AGJ.nr.232/23 të datës 05.10.2023.

Kryetari i gjykatës, pas analizimit dhe vlerësimit të ankesës së ankueses, shkresave të lëndës dhe deklaratës së nënkryetarit, gjeti se ankesa është e pabazuar.

Kryetari i gjykatës, ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit të paraqitura ndaj nënkryetarit të gjykatës D.H., se me rastin e vendosjes me aktvendimin AGJ.nr.232/23 të datës 05.10.2023 sipas kërkesës së ankueses për përjashtim të gjyqtarit, i njëjti ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të cilat përbëjnë shkelje disiplinore pasi që nuk ka qenë i autorizuar për të vendosur me arsyetimin se lidhur me kërkesën për përjashtim është kompetent për të vendosur kryetari i gjykatës, bazuar në nenin 70.1 të Ligjit për Procedurë Kontestimore dhe ka vlerësuar se ky pretendim i ankueses është i pa bazuar për faktin se organizimi, funksionimi, juridiksioni i gjykatave, kompetencat dhe përgjegjësit e kryetarit dhe nënkryetarit të gjykatave janë të përcaktuara dhe rregulluara me Ligjin për Gjykatat, si dhe me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore dhe degët e tyre.

Nënkryetari D.H., me rastin e marrjes së këtij aktvendimi ka vepruar konform autorizimeve ligjore meqenëse me Ligjin për Gjykatat, gjegjësisht me nenin 14 paragraf 4 të këtij ligji është e përcaktuar se nënkryetari i gjykatës ushtron detyrat e kryetarit të gjykatës në mungesë të tij. Po ashtu, edhe me nenin 6 të Rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore dhe degët e saj, janë të përcaktuara kompetencat dhe përgjegjësit e nënkryetarit, ku është e përcaktuar se nënkryetari i gjykatës ndihmon kryetarin në menaxhimin e Gjykatës dhe në mungesë të tij i njëjti shërben si ushtrues detyre i kryetarit të gjykatës. Gjatë kësaj periudhe kohore kur është marr aktvendimi AGJ.nr.232/23, kryetari i gjykatës nuk ka qenë në punë dhe detyrat e kryetarit i ka ushtruar nënkryetari, andaj bazuar në këto dispozita ligjore nënkryetari ka vepruar konform dispozitave ligjore, pasi që i njëjti ka autorizime ligjore që në mungesë të kryetarit të gjykatës ta ushtroi detyrën e kryetarit ashtu siç ka vepruar edhe me rastin e marrjes së vendimit AGJ.nr.232/23.

Andaj, mbi këto baza dhe argumente vërtetohet se në veprimet e nënkryetarit nuk janë konstatuar shkelje të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore, për këtë arsye kryetari i gjykatës gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi nga të lartcekurat nuk rezulton se veprimet e ndërmarra nga nënkryetari D.H., përbëjnë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 9 par. 6 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par. 3 pika 3.2 të Rregullores 05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**AD-GJTHGJA. nr. 03/2023, datë 20.11.2023**

**Kryetari i Gjykatës**

\_\_\_\_\_  
**Nikollë Komani**

*Vendimi t'i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës,*
- 2. Parashtruesit të ankesës,*
- 3. Gjyqtarit,*